



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
VLORË

Nr. 167 Prot.

Vlorë, më 02.04.2024

ANALIZA E TË DHËNAVE STATISTIKORE TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË
PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM VLORË TË VITIT 2023

Materiali vijues përfaqëson në mënyrë të përmbledhur punën e kryer nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë gjatë vitit kalendarik 2023 dhe problematikat e hasura gjatë këtij viti sa i takon funksionimit të institucionit në tërësi.

Analiza e veprimtarisë së Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për vitin 2023, paraqet një rëndësi të madhe, pikërisht për faktin se zhvillohet në një periudhë tranzicioni ligjor, për shkak të ndryshimeve të fundit të Kodit të Procedurave Civile dhe Penale, mbi bazën e të cilëve procedon kjo Gjykatë.

Në këtë analizë të veprimtarisë së Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, përshkruhet veprimtaria e plotë dhe organizimi i Gjykatës së Vlorës, një ndër gjykatat që ka një ngarkesë të madhe pune.

Kjo analizë ka në përmbajtje të saj një përshkrim të përgjithshëm të Gjykatës, procesin e punës në gjykatë, menaxhimin e seancave gjyqësore, aktorët e sistemit të drejtësisë, të dhëna për çështjet me vendim pushimi, vendim pranimi dhe rrëzimi, administrimin e gjykatës veprimtarinë e gjykatës, afatet kohore procedurale dhe vlerësimi.

Gjithashtu pasqyrohen statistikave për dhomën civile (çështje civile, tregtare, familjare), statistikave për dhomën penale (çështje penale, seanca paraprake, masa sigurimi)

Nga analiza e statistikave të vitit 2023, arrijmë në përfundimin se një gjykatë me një volum pune kaq të lartë siç mund të shihet lehtë nga statistikave, tabelat në përmbajtje të këtij punimi, e ka domosdoshmëri shtimin e organikës në përputhje me kuadrin e ri ligjor në përmbushjen e misionit të gjykatës për dhënie të drejtësisë në mënyrën dhe kohën e duhur. Gjithashtu domosdoshmëria e shtimit të organikës është lënë detyrë edhe nga Raporti i Auditit të KLSH-inspektimit që është zhvilluar në KLGJ për vitin 2023.

Në kuadër të projektit të USAID dhe OSCE “Drejtësi pa vonesa”, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka dhënë kontributin e saj për këtë nismë e cila synon rritjen e efikasitetit të proceseve gjyqësore në Shqipëri. Gjyqtarët dhe personeli gjyqësor, me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë dhe vendas, kanë analizuar shkaqet e vonësive në proceset gjyqësore me qëllim që të merren masa për një planifikim të administrimit më të mirë të çështjeve, duke forcuar bashkëpunimin me palët në gjykim, përfshirë dhe institucionet shtetërore.

Në vijim të bashkëpunimit, Gjykata e Vlorës ka patur mbështetjen e rëndësishme nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili ka vënë në dispozicion të gjykatës punonjës shtesë me qëllim dhënie të ndihmës për të përmirësuar shërbimet në marrëdhëniet me publikun, rritjen e sigurisë së ambjentëve të gjykatës, si dhe punonjës shtesë për arkivën.

I. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I GJYKATËS.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka në organikën e saj me dekret **16 (gjashtëmbëdhjetë)** gjyqtarë.

Gjatë vitit 2023 organika e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, është shtuar me 5 gjyqtarë të rinj.

Në periudhën Janar – Shkurt 2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka patur 9 gjyqtarë.

Në periudhën Shkurt – Tetor 2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka patur 10 gjyqtarë.

Në periudhën Tetor - Dhjetor 2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka patur 13 gjyqtarë. (Emëruar 4 gjyqtarë të rinj. Shkarkuar nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit 1 gjyqtar.)

Me vendimin e Këshillit të Gjykatës nr. 104 Prot, datë 14.11.2023 “Mbi caktimin në seksione dhe organizimin në trupa, të gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë” është bërë ndarja në dy seksione: Seksioni për të Mitur është ndryshuar dhe është krijuar “Seksioni për të mitur, i Çështjeve Familjare dhe i kërkesave të veçanta” dhe “Seksioni i Përgjithshëm”.

- Seksioni për të Mitur, i Çështjeve Familjare dhe i kërkesave të veçanta, sipas vendimit nr. nr. 104 Prot, datë 14.11.2023 të Këshillit të Gjykatës, do të marrë short dhe do të gjykojë këto çështje: Çështje Penale: Penale hetime, seancë paraprake, themeli ku personi është i pandehur, nën hetim etj apo viktimë e mitur sipas përcaktimeve të ligjit nr.37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur” si dhe përcaktimeve të K.Pr.Penale. Çështjeve Familjare: Zgjidhje martesë, Lëshim autorizimi, Birësim, Njohje/kundërshtim atësie, Urdhër mbrojtje, si dhe çështje të tjera familjare sipas Kodit të Familjes dhe Kodit të Proçedurës Civile. Çështje Civile: Marrëdhënie pune sipas përcaktimeve të Kodit të Punës, Vërtetim fakti juridik sipas neneve 338 e vijues te Kodit të Proçedurës Civile, Ndhma juridike falas sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, Urdhërat e ekzekutimit për vendimet që janë dhënë nga gjyqtarët e këtij seksioni sipas nenit 511 të Kodit të Proçedurës Civile.

- Seksioni i Përgjithshëm, sipas vendimit nr. nr. 104 Prot, datë 14.11.2023 të Këshillit të Gjykatës, do të marrë short dhe do të gjykojë të gjitha llojet e çështjeve që nuk gjykohen nga Seksioni për të Mitur, i Çështjeve Familjare dhe i kërkesave të veçanta.

Gjithashtu Me vendimin e Këshillit të Gjykatës nr. 104 Prot, datë 14.11.2023 “Mbi caktimin në seksione dhe organizimin në trupa, të gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë” është bërë caktimi i gjyqtarëve që do të gjykojnë në Seksionin e Përgjithshëm dhe Seksionin për të Mitur, i Çështjeve Familjare dhe i kërkesave të veçanta. Konkretisht Seksioni i Përgjithshëm përbëhet nga 10 (dhjetë) gjyqtarë ndërsa Seksioni për të Mitur, i Çështjeve Familjare dhe i kërkesave të veçanta përbëhet nga 6 (gjashtë) gjyqtarë.

Po kështu, me vendimin nr.253 Prot, datë 27.07.2021 të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, është krijuar njësi ndihmëse e gjyqtarëve, në përbërje të së cilës janë 8 sekretare gjyqësore te cilat kanë qënë pa gjyqtarë. Kjo njësi ka ndikuar ndjeshëm në lehtësimin e punës së gjyqtarëve duke kryer veprimet paraprake,

projekt-vendime (themeli, urdhra ekzekutimi, të ndërmjetme etj) dhe projekt-urdhra dhe ka ulur kohën e zbardhjes së vendimeve. *(sipas librave mbi 2729 dosje të punuara nga njësia nga muaji janar 2023 deri në dhjetor 2023.)*

Gjykata ne vitin 2023 ka një staf, prej të cilëve:

- ❖ 16 Gjyqtarë në organikë;
- ❖ 1 Kancelare;
- ❖ 2 Kryesekretare;
- ❖ 26 Sekretare gjyqësore (ku përfshihen 8 sekretare të njësisë);
- ❖ 1 Shefe Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar;
- ❖ 1 Specialist Finance;
- ❖ 1 Specialist Buxheti;
- ❖ 1 Shefe Sektori I Burimeve Njerzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve;
- ❖ 1 Specialist i Prokurimeve;
- ❖ 1 Shef Sektori i IT, Statistike dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Median;
- ❖ 1 Specialist IT;
- ❖ 1 Specialist për Marrëdhënien me Publikun dhe Median;
- ❖ 1 Shefe Sektori Protokoll/Arkivë;
- ❖ 1 Specialist Arkive;
- ❖ 1 Specialist Protokolli;
- ❖ 4 Ftues;
- ❖ 2 Mirëmbajtës;
- ❖ 2 Shofer;
- ❖ 4 Punonjës sigurie;
- ❖ 4 Sanitar;
- ❖ 1 Magazinier;
- ❖ 2 punonjës me kontrate 1 vjecare të miratuar nga KLGj.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, në zbatim të vendimit nr.555 datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore” ka parë të domosdoshme miratimin e strukturës dhe organikës së administratës së gjykatës, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Për shkak të miratimit të ligjit nr.98/2016 dhe ndryshimeve të po këtij ligji, me qëllim përshtatjen dhe harmonizimin me të, ka lindur e domosdoshme ndryshimi i rregullores së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Me vendimin nr.895 Prot., datë 30.01.2023 të Këshillit të Gjykatës “Për miratimin e strukturës dhe organikës së administratës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor” është vendosur: “Miratimi i strukturës dhe organikës se Administratës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në shtojcën nr.2 dhe konkretisht: Administrata gjyqësore ishte 37, bëhet 55; Nëpunës civil gjyqësor ishte 27, bëhet 38; Punonjës të tjerë gjyqësor ishte 10, bëhet 17”.

Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin nr.894 Prot., datë 30.01.2023, për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren e brendshme “Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”, miratuar me urdhër nr.42 Prot., datë 15.02.2018; ndryshuar me urdhër datë 18.02.2019; ndryshuar me vendim të

Këshillit të Gjykatës në muajin Korrik 2021, është bërë ndryshimi i rregullores së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë përsa i përket komeptencave të Kancelarit dhe Kryesekretarit.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, në zbatim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (Kreu 2, neni 5 dhe neni 37 i ligjit në fjalë), ligjit nr.98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, dhe Urdhërit nr.15 datë 20.02.2023, “Për ngritjen e Grupit të Monitorimt”, ka hartuar Rregulloren e Brendshme të Grupit të Monitorimit në lidhje me mbikëqyrjen e sjelljes së nëpunësit civil gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhjet vendore duke përcaktuar objektin e veprimtarisë dhe vendosjen e disa rregullave të hollësishme të cilat duhet të ndiqen nga nëpunësit civilë gjatë periudhës së fushatës elektorale dhe të cilat do të jenë objekt i kontrollit të grupit “ad-hoc”, të ngritur në këte rast.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë mbulon si kompetencë territoriale një territor që përbëhet nga Bashkia Vlorë, Bashkia Selenicë dhe Bashkia Himarë. Bashkia Vlorë për vitin 2023 ka një popullsi mbi 194.147 banorësh, Bashkia Himarë ka një popullsi mbi 27.049 banorësh, ndërsa Bashkia Selenicë ka një popullsi mbi 15.378, pra në total mbi 236.574 banorë.

Sipërfaqja tokësore e Bashkisë Vlorë është 616.85 Km², Bashkisë Himarë është 571.94 Km², 561.24 km², ndërsa Bashkia Selenicë. pra në total 1750.03 Km².

Kjo është një e dhënë që na ndihmon të kemi një perceptim të qartë të numrit të çështjeve civile dhe ngarkesës së punës që kryhet në këtë Gjykatë.

Numri i çështjeve të gjykuara nga Gjykata e Vlorës për vitin 2023 paraqitet si më poshtë:

Lloji i çështjeve		Çështje Civile	Çështje Penale	Total
Numri gjithsej	Çështje të mbartura nga viti 2022	1582	772	2354
	Çështje në pritje deri në datë 31 dhjetor 2023	1655	688	2343
	Çështje të ardhura gjatë vitit 2023	2373	2412	4785
	Çështje të përfunduara gjatë vitit 2023	2300	2496	4796

Duke përfshirë edhe këto kërkesa, për vitin 2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë paraqet ngarkesën si më poshtë vijon :

- nr. total i çështjeve të gjykuara është **4796**;
- nr. total i çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme është **2354**;
- nr. total i çështjeve të mbartura për vitin 2024 është **2343**;
- nr. total i çështjeve regjistruara ne vitin 2023 është **4785**;
- nr. total i gjyqtarëve sipas organikës **16**. (Janar deri në muajin Shkurt 2023, 9 gjyqtarë efektivë; Shkurt deri në Tetor 2023, 10 gjyqtarë efektivë; Tetor deri në Dhjetor 2023, 13 gjyqtar efektivë).

Çështje të mbartura 01.01.2023	Çështje të reja	Çështje të përfunduara	Çështje të mbartura për vitin 2024
2354	4785	4796	2343

Koeficienti i mesatares së çështjeve për gjyqtarë:

$$\frac{2354 + 4785 = 7139 \text{ (numri i të regjistruara + mbartura)}}{14 \text{ (numri i gjyqtarëve efektivë)}} \sim \mathbf{510 \text{ çështje për gjyqtar.}}$$

II. PROCËSI I PUNËS NË GJYKATË.

Në muajin nëntor 2023 pas mbledhje se përgjithshme të gjyqtarëve, Zv/Kryetari i Gjykatës dhe Këshilli i Gjykatës në bazë të kompetencës që i jep ligji kanë bërë ndarjen e gjyqtarëve në trupa gjykues të përgjithshëm dhe në seksionin për të mitur, çështjeve familjare dhe kërkesave të veçanta.

Çështjet gjyqësore shpërndahen në mënyrë transparente, nëpërmjet shortit elektronik të zhvilluar nëpërmjet sistemit ICMIS. Gjithashtu për shkak të azhornimit të sistemit “ICMIS” dhe plotësimi i trupave gjyqësore behet me short elektronik në sistem dhe jo më short me gogla.

Në datën 1 Gusht 2017 kanë hyrë në fuqi ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale të cilat kanë rritur rolin e gjykatës duke e shtrirë edhe në fazën e hetimeve paraprake, konkretisht gjyqtari penal duhet të shqyrtojë masat e sigurimit dhe çdo kërkesë tjetër që i paraqitet gjatë fazës së hetimeve paraprake¹ gjyqtari i seancës paraprake i cili gjykon kërkesat e prokurorit për pushimin e akuzës ose çështjes për krimet dhe kërkesën e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq, si dhe gjyqtari i themelit, i cili ka të njëjtat kompetenca, por si risi e këtij kodi pothuajse të ri, do të japë vendim për marrëveshjen e arritur ndërmjet prokurorisë dhe të pandehurit, si dhe urdhrin penal.

Me ligjin nr. 41 datë 23.03.2021 kanë hyrë në fuqi ndryshimet e reja sipas së cilës në rastin e pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar në seance paraprake, gjykimi i themelit vijon nga i njëjti gjyqtar. Kjo ka ndikuar në shkurtimin e kohës së gjykimit të çështjeve dhe në moszvarritjen e gjykimeve.

Me datë 5 Nëntor 2017 kanë hyrë në fuqi ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Civile, efektet e të cilave u evidentuan gjatë vitit 2018 e në vazhdim, pasi dispozitat kalimtare parashikonin se për çështjet e regjistruara para kësaj date, do të vijohet sipas procedurës së vjetër civile. Me ndryshimet e reja të Kodit, gjyqtarët fillimisht kryejnë veprimet paraprake në lidhje me dosjet dhe më pas kalojnë çështjet në seancë përgatitore ose gjyqësore.

¹ Neni 15/1 i K.Pr.Penale - Nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake ose në seancë paraprake për të njëjtin procedim. Gjyqtari që shqyrton kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit të seancës paraprake në të njëjtin procedim

II.a MENAXHIMI I SEANCAVE GJYQËSORE.


Gjyqtarët trajtojnë me prioritet çështjet që janë urgjente dhe sensitive ndërsa dakortësojnë me palët rregullisht (për aq sa është e mundur) për kalendarin e gjykimit të çështjes gjyqësore. Çështjet gjyqësore që u janë caktuar me anë të shortit elektronik, vihen në lëvizje sa më shpejt të jetë e mundur. Çështjet penale me të arrestuar vihen në lëvizje brenda 1 deri në 3 javë kurse çështjet civile dhe seanca e parë përgatitore si rregull caktohet brenda tre ose katër muajve pas caktimit të relatorit. Për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe njoftimit të palëve ky afat shkon edhe mbi një vit.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka gjithsej 13 salla gjykimi me sistem audio dhe në 3 salla gjykimi audio mund të gjykohen personat e arrestuar/ndaluar pasi janë të pajisura me vendqëndrime për të pandehurit.

Më poshtë paraqitet tabela me numrin e seancave audio të zhvilluara nga çdo gjyqtar për periudhën 01.01.2023 deri në 31.12.2023, e shprehur kjo dhe në përqindje.

Gjyqtar	Nr. i seancave audio	Nr. i seancave në sallë	Nr. i seancave në zyrë	Totali i seancave të mbajtura	% seanca të regjistruara
Adelajda Gjuzi	8	8	0	8	100.0 %
Alba Ngresi	140	169	6	175	80.0 %
Alfred Konomi	40	42	0	42	95.2 %
Arbana Selmanaj	1109	1463	0	1463	75.8 %
Artan Çirraga	211	249	10	259	81.5 %
Dorina Stroka	1181	1309	0	1309	90.2 %
Emirjana Dimo	1191	1383	0	1383	86.1 %
Enkel Peza	1115	1278	1	1279	87.2 %
Eranda Cufo	150	111	88	199	75.4 %
Fjorald Behari	155	156	16	172	90.1 %
Hektor Sinanaj	1957	2341	0	2341	83.6 %
Herila Çela	643	824	1	825	77.9 %
Laurent Fuçia	469	574	0	574	81.7 %
Lirëza Sinollari	1032	838	350	1188	86.9 %
Mirela Mishgjoni	1230	1510	0	1510	81.5 %
Taulant Banushi	15	16	0	16	93.8 %
Vjola Canaj	1741	2094	0	2094	83.1 %
Totali	12387	14365	472	14837	83.4 %

Përdorimi i Sistemit Audio



Në grafik paraqitet totali i seancave gjyqësore të zhvilluara gjatë vitit 2023, ku rezulton se **83.48%** ose **12387** seanca gjyqësore janë zhvilluar audio dhe **16.52 %** ose **2450** seanca nuk janë zhvilluar me sistemin Audio.

Është konstatuar se të gjitha seancat gjyqësore në të cilat nuk është përdorur sistemi i regjistrimit audio janë seanca të masave të sigurimit, çështje të hetimit paraprak të cilat në bazë të Kodit të Procedurës Penale konsiderohen sekret hetimor, si dhe çështje të seancave paraprake të cilat zhvillohen me dyer të mbyllura. Për sa u përket çështjeve civile, seanca të mbajtura pa sistemin audio rezultojnë të jenë disa çështje familjare për të cilat gjyqtarët kanë çmuar se prevalon mbrojtja e integritetit të të miturve apo privatësia e jetës personale e familjare të subjekteve, si dhe çështje për të cilat ligji procedural parashikon zhvillimin e tyre në dhomë këshillimi. Për mënyrën e mbajtjes së procesverbalit me shtypshkrim veprohet në bazë të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata ka sistemin e zhvillimit të seancave online të aprovuar nga KLGj gjatë pandemisë Covid19. Me kërkesë të Dhomës Avokatisë Vlorë ky sistem po përdoret gjërësisht edhe për zhvillimin e seancave të pajtimit sipas Kodit të Familjes, gjë që ka sjellë uljen e kohëzgjatjes së gjykimit dhe uljen e shpenzimeve për qytetarët Shqiptarë që ndodhen jashtë territorit të Shqipërisë, pasi nuk i duhet të vijnë më fizikisht në Shqipëri por mund ta zhvillojnë seancën online dhe në distancë në shtetin ku banojnë e jetojnë. Po shikohet mundësia për aplikimin e këtij sistemi edhe shtetasit Shqiptar që jetojnë e banojnë në Shqipëri por që ndodhen në qytete të tjera dhe nuk mund të paraqiten për arsye punë apo arsye të tjera të ligjshme.

II.b PROCEDURAT NË GJYKATË.

Në korrik të vitit 2021 me ndryshimin e ambienteve dhe marrjen e masave të sigurisë aksesit i publikut dhe i përdoruesve të gjykatës u nda nga ambientet e tjera të gjykatës (aksesi në sallat e gjykimit).

Përdoruesit e gjykatës i drejtohen gjykatës me anë të kërkesave civile-penale, padive, ankesave etj të cilat depozitohen dhe trajtohen nga 2 sportele që funksionojnë sipas orarit të përcaktuar.

Për aktorët e tjerë të sistemimit të drejtësisë siç janë Avokatët apo përfaqësuesit e tjerë të palëve funksionon një sportel i veçantë sipas një orari të përcaktuar².

Kërkesat dhe paditë regjistrohen nga Kryesekretaria në ditën e paraqitjes së tyre në gjykatë dhe i nënshtrohen shortit brenda ditës. Këtu vlen të përmendet fakti që shorti në Gjykatën e Vlorës organizohet çdo ditë nga e hëna në të premte në orën 15:30 duke shmangur kështu qëndrimin e çështjes pezull pa veprime në kryesekretari.

Në regjistrat penal regjistrohen të gjitha kërkesat që vijnë nga prokuroria, nga të pandehurit, të dëmtuarit akuzues, personat në cilësinë e viktimës. Ndryshimet e reja në kodet e procedurave penale dhe civile kanë synuar rritjen e transparencës së pushtetit gjyqësor, duke fuqizuar rolin e gjykatës, duke sjellë si pasojë shtimin e procedurave formale para gjykatës, përmendim këtu ndryshimet në kodin e procedurës civile ku komunikimi i gjykatës me palët është vetëm më shkrim dhe zgjat në kohë, sikurse edhe ndryshimet në kodin e procedurës penale, ku për herë të parë i dëmtuari nga vepra penale “viktima” në seancën paraprake ka rol aktiv, ndërsa duhet të marrë njoftim për seancën e parë gjyqësore. Problemi i vetëm që është hasur në këto kohë nga ana e gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatës ka qenë njoftimi i palëve për të marrë pjesë në proces.

III. AKTORËT E SISTEMIT TË DREJTËSISË.

Gjykata ka një komunikim të mirë dhe frytdhënës me Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, që ndihmon në mbarëvajtjen e punës për të dy institucionet.

Po kështu një bashkëpunimin i mirë është edhe me Dhomën e Avokatisë e cila në mënyrë të rregullt ka përcjellë listën e gatishëmisë të avokatëve kryesisht, procedurë që duhet ndjekur dhe përzgjedhjen e tyre sipas specializimit. Në muajin korrik dhe shtator 2021 u plotësuan dy kërkesa të Dhomës Avokatisë Vlorë që kishin të bënin me hapjen e një sporteli të dedikuar për Avokatët në një orar të caktuar si dhe një sallë më qëllim studimin e dosjeve.

Gjykata e Vlorës ka patur një bashkëpunim intensiv dhe ka qenë e hapur për të gjitha projektet e OJF-ve, duke u vënë në dispozicion informacionin e nevojshëm për çdo rast.

² Orar i dakordësuar me përfaqësues të Dhomës së Avokatisë Vlorë.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me :

- Qendrën Psiko-Sociale “Vatra” me objekt forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimeve me qëllim asistimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore.
- Bashkinë Vlorë, Selenicë dhe Himarë, Policinë e Vlorës dhe Himarës, Zyrës së Përmbartimit Vlorë, Spitalin Rajonal Vlorë, Drejtorinë Arsimore Vlorë, Prefekturën Vlorë me objekt ngritjen e mekanizimit të bashkëpunimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij.
- Qendra e Shërbimit dhe Praktika Ligjore të Integruara me objekt orientimin e shërbimit ligjor dhe psikologjik falas për të miturit e përfshirë në çështjen penale që gjykohen pranë seksionit të të miturve.

Për Gjykatën mbetet një problem shumë i rëndësishëm mungesa e adresave të sakta zyrtare dhe njoftimi i Avokateve dhe palëve në adresat elektronike të njohura rregullisht, që sjell si pasojë shtyrjen e seancave gjyqësore. Për zgjidhjen e kësaj problematike në lidhje me njoftimet po shikohet mundësia e një projekti pilot me qëllim njoftimin e avokatëve nëpërmjet një sistemi online në adresat e emailit.

**IV. KOHËZGJATJA MESATARE NË MUAJ PËR PERIUDHËN 01 JANAR 2023
– 31 DHJETOR 2023. VEPRIMTARIA E GJYKATËS, AFATET KOHORE
PROCEDURALE DHE VLERËSIMI.**

Sistemi i Informatikë të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore ICMIS nuk mundëson nxjerrjen e statistikave në nivel gjykate mbi vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të proceseve gjyqësore, sipas llojit të tyre, por të dhënat statistikore vazhdojnë të nxirren në mënyrë manuale.

V.a SHPEJTËSIA NË GJYKIM.

Përsa i përket shpejtësisë në gjykim, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë paraqet tregues të kënaqshëm në funksion të dhënies së drejtësisë, brenda një afati të arsyeshëm kohor sipas detyrimeve procedural dhe parashikimeve kushtetuese të nenit 42/2, nenit 399/2 i K.Pr.Civile dhe nenit 6§1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

- **Çështjet Civile të mbartura nga viti 2007 - 2023, paraqitet tabela si më poshtë:**


Çështjet të mbartura në vite – “Backlog cases”	Numri i çështjeve për çdo vit
Viti 2007	1
Viti 2010	1
Viti 2011	2
Viti 2012	2
Viti 2014	4
Viti 2015	6
Viti 2016	10
Viti 2017	15
Viti 2018	24
Viti 2019	52
Viti 2020	116
Viti 2021	408
Viti 2022	1713
Total	2354

Vlen të theksohet se çështjet civile të mbartura nga viti 2007, 2010, 2011, 2012, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019 janë çështje pjesëtimi i pasurisë, ku gjykata ka dhënë vendimin e fazës së parë të pjesëtimin dhe dosjet fizikisht ndodhen në shqyrtim në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë mbi bazën e ankimeve / rekurseve të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, mbi vendimin e ndërmjetëm të fazës së parë të pjesëtimin të pasurisë. Gjithashtu ka dosje të pezulluara civile dhe penale.

➤ Statistika mbi shpejtësinë e përfundimit të çështjeve civile.

Lloji i çështjes	< 6 muaj	6 - 12 muaj	1 - 2 vjet	> 2 vite
Civile të përgjithshme civile me palë kundërshtare	188	185	165	84
Familjare me palë kundërshtare	408	340	17	0
Zgjidhje martese	195	318	11	0
Tregtare me palë kundërshtare	1	0	0	0
Marrëdhënie pune	17	29	7	3
Të përgjithshme civile pa palë kundërshtare	661	113	10	0
Familjare pa palë kundërshtare	29	42	0	0
Tregtare pa palë kundërshtare	1	0	0	0
Faliment	0	0	0	0
TOTALI CIVILE	1500	1027	210	87


Çështje të përfunduara civile gjatë vitit 2023



➤ Statistika mbi shpejtësinë e përfundimit të çështjeve penale.

Lloji i çështjes	< 6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	> 2 vite
Krime	379	20	1	0
Vrasje me dashje (Neni 76,77,78,78/a,79, 79/a,79/b,79/c,81,82,83)	3	1	0	0
Vjedhje (neni 139, 140, 141)	2	0	0	0
Dhuna në familje	16	1	3	0
Krime të kryera nga ose ndaj të miturve	5	0	0	0
Kundërvajtje penale	93	6	8	2
Kundërvajtje penale të kryera nga ose ndaj të miturve	2	0	0	0
Çështje penale administrative	1647	229	111	0
Masa sigurimi	712	0	0	0
Lirim me kusht	3	0	0	0
Ekstradime	7	0	0	0
Çështje të ligjit Antimafia	0	0	0	0
TOTALI PENALE	2119	255	120	2

Çështje Penale të përfunduara gjatë vitit 2023



V.b STATISTIKA PËR ÇËSHTJET CIVILE

➤ Çështje civile të paraqitura në gjykatë.

Lloji i çështjes	ADMINISTRIMI I ÇËSHTJEVE				
	Në pritje të gjyqimit në fillim të periudhës	Çështje të reja të paraqitura në gjykatë	Çështje të gjykuara gjithsej	Në pritje të gjyqimit në fund të periudhës	Çështje të regjistruara gjithsej
	1	2	3	8	9
Çështje civile me palë kundërshtare (A.1+A.2+A.3+A.4)	1324	1449	1444	1329	2773
Civile të përgjithshme civile me palë kundërshtare	822	577	622	777	1399
Familjare me palë kundërshtare	428	781	765	444	1209
Zgjidhje martese	320	513	524	309	833
Tregtare me palë kundërshtare	5	1	1	5	6
Marrëdhënie pune	69	90	56	103	159
Çështje civile pa palë kundërshtare (B.1+B.2+B.3)	258	924	856	326	1182
Të përgjithshme civile pa palë kundërshtare	200	855	784	271	1055
Familjare pa palë kundërshtare	57	68	71	54	125
Tregtare pa palë kundërshtare	1	1	1	1	2
Faliment	0	0	0	0	0
TOTALI CIVILE	1582	2373	2300	1655	3955

V.c STATISTIKA PËR ÇËSHTJET PENALE

➤ Çështje penale të paraqitura në gjykatë.

Lloji i çështjes	ADMINISTRIMI I ÇËSHTJEVE				
	Në pritje të gjyqimit në fillim të periudhës	Çështje të reja të paraqitura në gjykatë	Çështje të gjykuara gjithsej	Në pritje të gjyqimit në fund të periudhës	Çështje të regjistruara gjithsej
	1	2	3	8	9
Krime	161	438	400	199	599
Vrasje me dashje (Neni 76,77,78,78/a,79, 79/a,79/b,79/c,81,82,83)	4	3	4	3	7
Vjedhje (neni 139, 140, 141)	2	4	2	4	6
Dhuna në familje	12	21	20	13	33
Krime të kryera nga ose ndaj të miturve	1	27	5	23	28
Kundërvajtje penale	64	101	109	56	165
Kundërvajtje penale të kryera nga ose ndaj të miturve	2	0	2	0	2
Çështje penale administrative	547	1873	1987	433	2420
Masa sigurimi	4	719	712	11	723
Lirim me kusht	0	11	3	8	11
Ekstradime	0	7	7	0	7
Çështje të ligjit Antimafia	0	0	0	0	0
TOTALI PENALE	772	2412	2496	688	3184

➤ **Detajimi i mënyrës së përfundimit të çështjeve penale.**

	Me vendim fajësie	Me vendim pafajësie	Pushim vendimi	Kthim për plotësim hetimesh	Vendosur moskompetenca
Nr. çështje	483	15	8	3	0
%	94.8 %	2.9 %	1.5 %	0.58 %	0

➤ **Detajimi i masave të dënimit dhe personave të gjykuar.**

Me gjobë	Deri 2 vjet	2-5 vjet	5-10 vjet	10-25 vjet	25-35 vjet	Burgim i përjetshëm	TOTALI
64	331	77	38	7	0	0	517

➤ **Detajimi i masave të dënimit dhe personave të gjykuar.**

	Të dënuar femra	Të dënuar meshkuj	Të dënuar gjithsej
Nr.	16	514	530
%	3.01 %	96.9 %	

➤ **Detajimi i masave të dënimit dhe personave të gjykuar.**

	Të dënuar të mitur	Të dënuar të rritur	Të dënuar gjithsej
Nr.	5	525	530
%	0.94 %	99 %	

➤ **Detajimi i disponimeve për çështjet civile.**

LLOJET E DISPONIMIT					
	Pranuar	Zgj.pajtim	Refuzuar	Pushuar	Moskompetencë
Nr.	1241	4	304	674	77
%	53.9 %	0.17 %	13.2 %	29.3 %	3.3 %

V.d NGARKESA E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE PËR GJYKATËN DHE PËR ÇDO GJYQTAR.

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme	Nr. çështjeve të regjistruara të reja (nga data 01 janar)	Nr. çështjeve të gjykuara	Nr. çështjeve në shqyrtim
1.	Arbana Selmanaj	404	414	569	249
2.	Dorina Stroka	82	443	393	132
3.	Enkel Peza	394	390	438	346
4.	Emirjana Dimo	111	433	419	125
5.	Hektor Sinanaj	451	503	646	308
6.	Herila Çela	207	200	407	-
7.	Laurent Fuçia	-	349	224	125
8.	Lirëza Sinollari	93	476	422	147
9.	Mirela Mishgjoni	253	436	491	198
10.	Vjola Canaj	345	413	534	224
11.	Artan Cirraga	-	188	76	112
12.	Alba Ngresi	-	178	56	122
13.	Eranda Cufo	-	179	64	115
14.	Fjorald Behari	-	182	56	126
15.	Alfred Konomi	2	1	1	2
16.	Taulant Banushi	1	-		1
17.	Te tjere	11	-		11
	TOTALI	2354	4785	4796	2343

Po të vlerësojmë efikasitetin e kësaj gjykate sipas njërit prej treguesve kryesor të CEPEJ (Komisioni Europian për Efikasitetin në Drejtësi) “Clearance rate” që është norma e likuidimit të çështjeve ose rendimenti i çështjeve të përfunduara në një vit rezulton :

“Clearance rate” Penal (Treguesi Norma e Përfundimit/Likuidimit të Çështjeve)

$$CR_{penale} = \frac{(\text{numri i çështjeve të përfunduara})}{(\text{numri i çështjeve të reja})} * 100 = \frac{2496}{2412} * 100 = 103.4 \%$$

✚ Norma e likuidimit të çështjeve penale **103.4 %**.

“Clearance rate” Civil (Treguesi Norma e Përfundimit/Likuidimit të Çështjeve)

$$CR_{civile} = \frac{(\text{numri i çështjeve të përfunduara})}{\text{numri i çështjeve të reja}} * 100 = \frac{2373}{2300} * 100 = \mathbf{103.2 \%}$$

✚ Norma e likuidimit të çështjeve civile **103.2 %**.

“Case disposition Time” Penal (Koha e nevojshme për Përfundimin/Likuidimin e Çështjeve).

$$DT_{penale} = \frac{\text{numri i çështjeve në pritje për gjykim më 31.12.2023}}{\text{numri i çështjeve të zgjidhura}} * 365 = \frac{688}{2496} * 365 = \mathbf{101}$$

✚ Koha e nevojshme për përfundimin e çështjet Penale është **101 ditë**.

“Case disposition time” Civil (Koha e nevojshme për Përfundimin/Likuidimin e Çështjeve)

$$DT_{civile} = \frac{\text{numri i çështjeve në pritje për gjykim më 31.12.2023}}{\text{numri i çështjeve të zgjidhura}} * 365 = \frac{1655}{2300} * 365 = \mathbf{263}$$

✚ Koha e nevojshme për përfundimin e çështjeve Civile është **263 ditë**.

Siç konstatohet dhe nga këta treguesi rendimenti i përfundimit të çështjeve “Clearance rate” në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë gjatë vitit 2023 është në nivelet nga më të larta. Ky tregues pasqyron një rritje të theksuar të efikasitetit të kësaj gjykate në aspektin e shpejtësisë së gjykimit.

V. ADMINISTRIMI I FONDEVE PUBLIKE.

Në fillim të vitit 2023, është akorduar një fond page dhe sigurime shoqërore në shumën prej 149.900.000 (njëqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind mijë) lekë, i cili është realizuar në masën 99.6%. Fondi i shpenzimeve operative është planifikuar në shumën 21.800.000 (njëzet e një milion e tetëqind mijë) lekë dhe është realizuar në masën 100%.

Pasqyrimi i fondeve në total:

Nr.	Përshkrimi i shpenzimit	Plani në lekë	Plani në lekë Fakt	Realizuar në %
1	Shpenzime për personelin paga dhe sigurime shoqërore	149.900.000	149.352.716	99,6 %
2	Shpenzime operative	21.800.000	21.791.180	100 %
3	Shpenzime për investimet (buxheti i shtetit)	4.700.000	4.284.290	91.2 %
4	Shpenzime operative (të ardhurat e institucionit)	299.000	279.640	93.5 %

VI. AKSESI, TRANSPARENCA, MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MEDIAN.

Me qëllim rritjen e aksesit në drejtësi, është rritur numri i formularëve standard për kërkesa të ndryshme drejtuar gjykatës. Gjithashtu është arritur asistenca e personave me aftësi të kufizuar nga një punonjës i gjykatës, përcaktimi i një ambienti të posaçëm për qëndrimin, publikimi i të drejtave dhe garancive. Gjatë vitit 2023 në drejtim të rritjes së transparencës dhe aksesit në drejtësi, ka vijuar aksesit nëpërmjet monitorit të vendosur në hollin e gjykatës dhe në ambientet e jashtme të gjykatës, nëpërmjet të cilit publiku, avokatët, përfaqësuesit ose palët kanë patur mundësi të marrin informacione në kohë reale mbi orarin e gjykimeve, shortin dhe informacione të tjera nga faqja zyrtare e internetit të gjykatës ose sistemi i gjykatës në çdo kohë pa patur nevojë të pyesin ose të presin në sekretarinë e gjykatës, qoftë edhe jashtë orarit të shërbimit. Gjithashtu, për lehtësimin e marrjes së informacionit, nëpunësja e gjykatës për marrëdhëniet me publikun ka asistuar palët dhe publikun në përdorimin e këtij monitori dhe marrjen e informacionit të duhur. Gjykata ka publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji, për publikim kryesisht nga autoriteti publik. Në kuadër të ligjit për të drejtën e informimit gjatë këtij viti janë trajtuar nga gjykata kërkesat për informim të cilat janë paraqitur në rrugë elektronike. Për të gjitha kërkesat, brenda afatit ligjor është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar pa cënuar të drejtat e tjera, siç është mbrojtja e të dhënave personale. Në raport me median gjykata ka trajtuar kërkesat për informacione apo ndjekje të seancave gjyqësore për çështje për të cilat kanë patur interes publik. Në këto raste media apo gazetarët personalisht janë informuar me anë të njoftimeve elektronike si dhe në raste të tjera të veçanta me kërkesë të tyre është mundësuar prezenca në seancat gjyqësore publike duke mbajtur shënime.

VII. ÇËSH TJET E INFRASTRUKTURËS, ARKIVA, RUAJTJA DHE SIGURISË NË GJYKATË.

Nga muaji korrik 2021 gjykata ka 3 sportele. Njëri është sportel shërbimi për avokatët dhe dy sportelet e tjera njeri është për kërkesat civile dhe tjetri për kërkesat penale.

Nga muaji korrik 2021 janë marrë masa konkrete për përmirësim në drejtim të sigurisë së Gjykatës. Gjatë vitit 2023 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ka gjithësej 3 punonjës sigurie, një ndër të cilët është me kontratë një vjeçare në pozicionin e ftuesit dhe me urdhër të brendshëm, për shkak të nevojave të gjykatës, është caktuar të kryej detyrën e punonjësit të sigurisë.

Është ndarë hyrja e përdoruesve të gjykatës në sekretari dhe hyrja në sallat e gjykimit.

Hyrja e publikut për shërbime në sekretari është pa kontroll por me monitorim nga punonjësit e sigurisë.

Në hyrje të çdo kati që të çojnë në sallat të gjykimit janë vendosur 2 (dy) detektorë metalik si dhe dy rafta metalik për dorëzimin e sendeve personale nga palët (celularë, pajisje elektronike, çanta etj) që ruhen nga kamerat dhe dy punonjës të sigurisë së gjykatës të pajisur me mjet identifikimi.

Ambienti është i monitoruar me kamera dhe punonjësit e sigurisë ndihmohen nga punonjësit e Policisë së Shtetit të cilët janë prezent në ambientin e brendshëm. Hyrja në sallat e gjykimit për palët realizohet pasi sekretarja gjyqësore ka thirrur palët në sistemin fonik dhe pasi palët kanë pranuar ti nënshtrohen kontrollit nga punonjësit e sigurisë kjo bazuar në VKM 538 datë 08.07.2020 “Për Përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për garantimin e rregullit e të sigurisë në gjykata dhe prokurori”, si dhe Rregulloren e Brendshme të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, e ndryshuar.

Nga muaji shtator 2021 nga ana e Bashkisë Vlorë u bë vijëzimi i ambjentit të parkimit rreth perimetrit të gjykatës dhe u vendos sinjalistike përkatëse. Ky ambjent sipas VKM 538 datë 08.07.2020 shërben për parkimin vetëm për mjetet e Gjyqtarëve dhe stafit të gjykatës.

Gjykata ka sistemin e monitorimit të lëvizjeve në ambientet e brendshme dhe të jashtme të gjykatës.

Gjithashtu janë marrë masa për monitorimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të integruar për mbrojtjen nga zjarri, përmbytjet dhe rreziqe të tjera.

Gjykata është e siguruar me policë sigurimi për rastet e fatkeqësive natyrore (tërmet, zjarr, përmbytje etj.)

Në fund të vitit 2021 është instaluar në një sallë gjykimi sistemi i seancave “online” video dhe audio i cili gjatë vitit 2022 po përdoret rregullisht nga gjyqtarët për çështjet civile, kryesisht ato familjare ku palët paraqesin kërkesë me shkrim për zgjidhje martese.

Mbetët një problem tepër shqetësues ambjenti i arkivës, pasi gjykata nuk ka më ambiente të lira për të arkivuar dosjet.

VIII. OBJEKTIVA DHE REKOMANDIME.

Analiza vjetore e punës në Gjykatën Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për vitin 2023, i shërben gjyqtarëve, stafit të gjykatës si dhe aktorëve të tjerë që kontribuojnë në dhënien e drejtësisë, për të përcaktuar qartë objektivat për vitet në vijim, për përmirësimin e cilësisë së dhënies së drejtësisë.

Objektivat e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, janë padyshim rritja e efikasitetit dhe efikasitetit të proceseve gjyqësore që nga regjistrimi i një kërkesë penale a civile, kërkesëpadie, e deri në dhënien e një vendimi final dhe dhënien e formës së prerë këtij vendimi.

Gjithashtu objektiv kryesor pas ndryshimeve të rëndësishme që kanë pësuar ligjet procedurale penale dhe civile, mbetet përafrimi dhe zbatimi tyre në një terren me një infrastrukturë jo të përshtatshme e mjaft të vështirë në të cilën ndodhet sot Gjykata e Vlorës. Aktualisht një pjesë e rëndësishme e ambienteve të gjykatës nuk është dispozicion të saj për shkak se i gjithë kati i tretë përdoret nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Kthimi i këtij ambienti Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë do të krijojë mundësinë e krijimit të një ambienti të përshtatshëm për arkivën e cila është në gjendje shumë të rënduar që po sjell si pasojë degradimin e dosjeve gjyqësore.

✓ Synimet e gjykatës për vitet në vijim janë :

- Rritja e efektivitetit dhe efikasitetit të proceseve gjyqësore;
- Rritja e integritetit dhe besueshmërisë në dhënien e drejtësisë me qëllim rritjen e besimit të publikut;
- Rritja e profesionalizimit dhe transparencës duke ruajtur të dhënat personale;
- Përmirësimi i infrastrukturës në kryesekretarinë e gjykatës për shpejtimin e hapave administrativë të një procesi gjyqësor;
- Forcimi i solemnitetit, pavarësisë dhe paanësisë së gjyqtarit;
- Përmirësim i burimeve njerëzore, shtimin e organikës, duke rritur cilësinë dhe performancën e shërbimeve të ofruara për përdoruesit e gjykatës.

✓ Objektiva afatshkurtër dhe afatmesëm janë:

- Rikonstruksion i jashtëm dhe brendshëm i godinës dhe përmirësim i vazhdueshëm i kushteve të punës. Emergjente është gjetja e ambienteve për arkivën e gjykatës;
- Vazhdimi i procesit të përpunimit të dosjeve gjyqësore për ruajtje të përhershme/përkohshme dhe asgjësim. Gjithashtu vazhdimi i procesit të dixhitalizimit të dosjeve.
- Intensifikimin e procedurës së njoftimeve elektronike të cilat do të ulin edhe shpenzimet e gjykatës për postën;
- Rishikimin e marrëveshjes me Posta Sha në lidhje me rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë në lidhje me shërbimin e dokumentacionit gjyqësor.

- Përpjekjet e vazhdueshme për të vjelur shpenzimet gjyqësore duke zbatuar kuadrin ligjor aktual;
- Trajnim i duhur për sekretarinë gjyqësore në drejtim të përmirësimit të aftësive kompjuterike, etikës së komunikimit me publikun dhe zbatimit të ndryshimeve të reja ligjore;
- Përmirësimi i rrjetit elektrik dhe kompjuterik, marrja e masave të përshtatshme për ruajtjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve si pasojë e ndërprerjes së energjisë elektrike si dhe ruajtjen nga sulmet e jashtme kompjuterike të mundshme;
- Përmirësimi i databasës për transferimin e dokumenteve gjyqësorë ndërmjet gjyqtarit dhe sekretarit, krijimi i një direktorie për ruajtjen e dokumenteve gjyqësore në serverin qendror të gjykatës;

✓ **Për arritjen e këtyre objektivave rekomandojmë:**

- Plotësimin dhe shtimin e numrit të përgjithshëm të Gjyqtarëve.
- Krijimi i organikave të përshtatshme sipas një strukture të përcaktuar, me specialistë sipas detyrave që kryejnë, të përshkruara në rregulloren e brendshme në zbatim të parashikimeve ligjore, do të rriste performancën e gjykatës, duke shmangur kryerjen e disa detyrave dhe punëve të ndryshme nga një person i vetëm.
- Bashkëpunim me donatorët dhe partnerët e huaj për projekte “Pilot”.
- Paraqitjen e raporteve periodike KLGJ-së, si dhe kërkesa kësaj të fundit në lidhje me problematikat që kërkojnë ndërhyrjen e KLGJ-së për zgjidhjen e situatave.

Të dhënat e analizuar dhe problematikat e ngritura në këtë analizë të statistikave për vitin 2023 do t’i shërbejnë si trupës gjyqësore, ashtu edhe institucioneve të tjera përkatëse që lidhen me sistemin gjyqësor. Dëshiroj të shpreh në emrin tim, të trupës gjyqësore dhe stafit të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë angazhimin tonë maksimal për rritjen në vijimësi të performancës së kësaj gjykate.

Në përfundim, duke përfituar nga rasti, falenderimet u shkojnë të gjithë gjyqtarëve, sekretareve gjyqësore si dhe gjithë stafit të gjykatës, të cilët me angazhimin e tyre kanë bërë të mundur përmbylljen e një viti shumë të ngarkuar dhe të vështirë, për shkak të mungesave të gjyqtarëve si pasojë e procesit të Vettingut.

**ZV/ KRYETAR I GJYKATËS
ENKEL PEZA**